



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



DATE:	21/03/2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Znj. Arbënesha Kuqi – Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	-Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Gjakovës -Arkivit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim për bashkëpunim komunal ndërkombëtar me Komunën e Bragës, Portugali.

Të nderuar,

Duke u bazuar në, nenin 12 pika (d), nenit 40 pika (j), dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal, si dhe neni 6 të Rregullores nr. 0203-1334 të dt. 18.12.2012 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar, Kryetari i Komunës parashton Kuvendit të Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Gjakovës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal;
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me Komunën e Bragës nga Portugalia;
3. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal;
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës.

KOMUNA E GJAKOVËS

KABINETI I KRYETARIT

Postal address: Nëna Tereze nr.469 Gjakovë, Kosovë
kk.rks-gov.net/gjakove/



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetari i Komunës

01 Nr. 011/01-4422

Dt. 21.03.2024

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, si dhe nenit 5 të Rregullores Për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar 0203-1334 të dt. 18.12.2012, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimi:

NISMËN
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E
BRAGA, PORTUGALI

NË FUSHËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE, EKONOMISË, KULTURËS, ARSIMIT,
TURIZMIT, MJEDISIT DHE TË TJERA

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Komunën e **Bragës, Portugali**;
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e administratës publike, ekonomisë, kulturës, arsimit, turizmit, mjedisit dhe të tjera, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat përkatëse. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik;
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës;
4. **Arsyetimi**- Nisma për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Bragës nga Republika e Portugalisë, bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy Komunave në fushat e lartcekura. Duke u nisur nga potenciali për bashkëpunim socio-ekonomik dhe kulturor të të dy qyteteve, si dhe në bazë të iniciativës nga ana e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Lisbona të Portugalisë, formalizmi i këtij bashkëpunimi përmes binjakëzimit të qytetit të Gjakovës dhe Bragës është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Kryetari i Komunës


Ardian Gjini

